# Plani Vendor i Barazisë Gjinore
2026-2028

BASHKIA PUSTEC

## Përmbajtja:

Parathënie........ 3
Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike........ 4
Analiza e situatës gjinore në territorin e bashkisë........ 6
Paraqitja e të dhënave Socio-Demografike........ 6
Analfabetizmi........ 8
Niveli Arsimor........ 9
Statusi martesor........ 11
Statusi i nënës........ 13
Frekuentimi i Çerdhes........ 15
Frekuentimi i Kopshtit........ 16
Të Dhëna mbi Personat me Aftësi të Kufizuar në Bashki........ 17
Punëkërkuesit e papunë sipas njësive administrative........ 20
Metodologjia........ 22
Vizioni dhe objektivat strategjike........ 23
Qëllimet dhe objektivat strategjike........ 24
Monitorimi dhe Raportimi........ 62

# Parathënie

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave ka qenë gjithmonë prioritet për Bashkinë Pustec. Në përpjekje për t'i çuar këto angazhime në një nivel më të thelluar, në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar, kemi ndërmarrë hapa konkretë për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet tona vendore. Me kënaqësi ju prezantojmë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Ky plan strategjik është ndërtuar përmes një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës, që ka përfshirë aktivisht drejtues dhe specialistë të bashkisë dhe njësive administrative, përfaqësues të komunitetit, institucione arsimore dhe shëndetësore, organizata të shoqërisë civile, si dhe ekspertë të Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, me mbështetjen teknike të Smart Processes.

Plani Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028 është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të nevojave lokale, duke reflektuar përvojën e akumuluar nga zbatimi i politikave të mëparshme në fushën e barazisë gjinore. Ky dokument merr parasysh praktikat më të mira, si dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, me synimin për të ndërtuar një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në promovimin e barazisë gjinore në nivel vendor.

Plani përmban masa të qarta dhe të strukturuara për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, si dhe për adresimin efektiv të dhunës me bazë gjinore në komunitet. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cenuara të shoqërisë, përfshirë gratë që jetojnë në zona rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara dhe ato që kanë përjetuar forma të ndryshme dhune.

Bashkia Pustec mbetet e angazhuar fuqishëm për ndërtimin e një shoqërie të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe të barabartë, ku të drejtat e çdo individi respektohen dhe garantohen pa përjashtim. Besojmë se arritja e këtij vizioni kërkon një përpjekje të përbashkët dhe një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, komunitetit dhe qytetarëve.

Prandaj, ftojmë të gjithë aktorët—pa dallim statusi apo fushe veprimi—të bëhen pjesë aktive në zbatimin dhe mbështetjen e këtij plani. Vetëm përmes angazhimit të përbashkët mund të garantojmë një të ardhme më të barabartë dhe më të drejtë për të gjitha gratë dhe vajzat e komunitetit tonë.

Angazhimi ynë, drejt një Bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!

# Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike

Në nivel lokal, kuadri ligjor dhe institucional që udhëheq përpjekjet për barazinë gjinore në Bashki ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,** neni 18/2, garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

**Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"**: Ky ligj përcakton parimet themelore të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe promovon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës publike. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për mbledhjen e statistikave gjinore dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e politikave gjinore në nivel vendor.

**Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**: Ky ligj i njeh bashkive një rol kyç në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore. Neni 6 i këtij ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Neni 62 u kërkon bashkive të respektojnë parimin e barazisë gjinore në emërimet në pozita drejtuese si nënkryetarë bashkie dhe administratorë njësish.

**Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"**: Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor vendor. Ai kërkon që ndarja dhe përdorimi i fondeve të buxhetit të orientohen drejt garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra, si dhe ofron fleksibilitet për të financuar politika që adresojnë nevojat gjinore.

**Ligji nr. 57/2016 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë,** përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një nga parimet e sistemit buxhetor. Kjo mbështet integrimin gjinor në planifikimin dhe menaxhimin financiar vendor.

**Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare",** i cili përcakton detyrimet e bashkive për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

**Ligji nr. 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"**, që ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor dhe e obligon pushtetin vendor të marrë masa për promovimin e barazisë.

**Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror",** i cili përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të margjinalizuara në nivel lokal.

**Ligji nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale",** i cili krijon mundësi për punësimin e grave në situata të pafavorshme përmes nxitjes së iniciativave lokale.

**Ligji nr. 75/2019 "Për rininë",** që sanksionon parimin e barazisë gjinore dhe garanton përfshirjen e vajzave të reja në jetën politike dhe sociale të bashkisë.

**Kodi i Punës,** me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2020**,** që detyron institucionet publike vendore të sigurojnë mjedis pune pa ngacmime dhe diskriminim për shkak të gjinisë. Ligji nr. 104/2014 për sigurimet shoqërore, që përfshin të drejtën e lejes prindërore për burrat dhe nënat që rikthehen në punë.

**Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti",** që siguron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të margjinalizuara.

**Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social",** që përcakton mbështetje për gratë viktima të dhunës në familje dhe trafikimit përmes banesave sociale.

**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021,** shërben si dokumenti udhëzues kryesor për këtë plan. Ajo orienton objektivat dhe masat strategjike për promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë (si CEDAË, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit, Objektivin e Zhvillit të qëndrueshëm 5, etj.).

Bashkia , nëpërmjet këtij Plani, harmonizon politikat vendore me këtë dokument kombëtar dhe merr përgjegjësi për zbatimin e tij në nivel lokal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik siguron themelin mbi të cilin Bashkia ndërton dhe zbaton politika të integruara për barazi gjinore, përfshirje dhe drejtësi sociale.

Plani është i harmonizuar me:

- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030
- Planin e zhvillimit 2026–2028 të Bashkisë Pustec
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 dhe 10
- Programin Kombëtar të Integrimit Evropian

# Analiza e situatës gjinore në territorin e bashkisë

Bashkia Pustec ndodhet në juglindje të Shqipërisë, përgjatë bregut të liqenit të Prespës, dhe përfaqëson një nga zonat me përbërje etnike të veçantë, ku një pjesë e madhe e popullsisë i përket minoritetit maqedonas. Territori i bashkisë është kryesisht rural, me vendbanime të vogla dhe një ekonomi të mbështetur kryesisht në bujqësi, blegtori dhe aktivitetet tradicionale të zonës. Për shkak të vendndodhjes gjeografike dhe karakterit të mbyllur të territorit, komuniteti ruan një identitet kulturor të dallueshëm dhe një strukturë sociale të ndikuar nga normat tradicionale. Kjo sjell nevojën për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore edhe në kontekstin e diversitetit kulturor dhe gjuhësor.

**Tabela nr.1 Bashkia Pustec:**

| Njesia Administrative | Tipologjia |
|---|---|
| Pustec | rural |

Bashkia Pustec përfshin 1 njësi administrative Tabela nr.1

Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth 1,843 **banorë**[1], me një shpërndarje të popullsisë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Në aspektin social, bashkia është përballur me sfida që lidhen me migrimin e të rinjve, papunësinë, dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve sociale, në veçanti për grupet më vulnerabël si gratë, të moshuarit, dhe personat me aftësi ndryshe.

Bashkia Pustec është e angazhuar në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke promovuar vlera si transparenca, barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, hartimi i **Planit të Barazisë Gjinore** përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

## Paraqitja e të dhënave Socio-Demografike

Tabela nr.2: Numri popullsinë sipas gjinisë[2]:

| Popullsia | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|
| Popullsia | 931 | 912 | 1843 | 50.5 | 49.5 |

[1] https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

[2] https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

*Burimi: INSTAT*

Tabela nr.3:Popullsia  e ndarë nëpër njësi administrative

| # | Njesia Administrative | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pustec | 931 | 912 | 1843 | 50.5 | 49.5 |

Grafiku nr.1: Popullsia meshkuj femra ne njesi admisitrative



## Analfabetizmi

Tabela nr.4: Analfabetizmi sipas gjinisë[3]

| Emërtimi | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|
| Banorë që nuk dinë shkrim e këndim | 14 | 33 | 47 | 29.8 | 70.2 |
| Banorë mbi 10 vjeç | 866 | 839 | 1705 | 50.8 | 49.2 |

**Tabela nr. 4** paraqet të dhëna mbi nivelin e analfabetizmit në Bashkinë Pustec, sipas gjinisë te banorët mbi 10 vjeç, 47 rezultojnë që nuk dinë shkrim e këndim.

Nga gjithsej **1,705 banorë mbi 10 vjeç** në Bashkinë Pustec, **47 persona** rezultojnë se **nuk dinë shkrim e lexim,** që përbën rreth **2.8% të popullsisë** në këtë grupmoshë. Brenda këtij grupi, **33 janë gra** dhe **14 janë burra,** çka do të thotë se **70.2% e personave që nuk dinë shkrim e lexim janë gra,** ndërsa vetëm **29.8% janë burra**.

Kjo shpërndarje gjinore është në kontrast me përbërjen pothuajse të barabartë të popullsisë mbi 10 vjeç, ku **50.8% janë burra** dhe **49.2% gra**. Pavarësisht kësaj barazie numerike, **gratë përfaqësojnë një përqindje më të lartë ndër personat që nuk kanë aftësi bazë në lexim dhe shkrim**.

Të dhënat pasqyrojnë një pabarazi në aksesin në arsim, me gratë më të ekspozuara ndaj analfabetizmit. Ky fenomen mund të jetë i lidhur me faktorë të tillë si normat tradicionale gjinore, mungesa e mundësive arsimore në të kaluarën, sidomos për gratë që i përkasin brezave më të vjetër ose që jetojnë në mjedise rurale apo të margjinalizuara.

Kjo situatë paraqet një pengesë serioze për pjesëmarrjen e grave në jetën publike, ekonomike dhe shoqërore, si dhe kufizon aksesin e tyre në informacion, punësim dhe ushtrimin e të drejtave qytetare. Prandaj, këto të dhëna theksojnë nevojën për masa të synuara brenda Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore, për të promovuar edukimin bazë të grave dhe vajzave që nuk janë përfshirë më parë në sistemin arsimor. **Programet për edukimin e të rriturve dhe fushatat e ndërgjegjësimit** janë të domosdoshme për të mbyllur këtë hendek dhe **për të garantuar përfshirje dhe barazi reale gjinore** në komunitet.

[3]https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

## Niveli Arsimor

Tabela nr. 5 paraqet shpërndarjen gjinore të popullsisë sipas nivelit të arsimit në Bashkinë Pustec. Të dhënat tregojnë dallime të dukshme midis meshkujve dhe femrave në nivele të ndryshme arsimore, duke reflektuar sfida të mundshme në drejtim të barazisë gjinore në arsim dhe përfshirjen sociale.

Tabela nr. 5 – Shpërndarja gjinore sipas nivelit të arsimimit në Bashkinë Pustec[4]

| # | Emërtimi | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Asnjë nivel arsimor i përfunduar | 5 | 13 | 18 | 27.8 | 72.2 |
| 2 | Arsimi Fillor | 65 | 106 | 171 | 38.0 | 62.0 |
| 3 | Shkollë 7/8/9 vjeçare | 325 | 376 | 701 | 46.4 | 53.6 |
| 4 | Shkollë e mesme | 328 | 226 | 554 | 59.2 | 40.8 |
| 5 | Bachelor | 44 | 41 | 85 | 51.8 | 48.2 |
| 6 | Master ose Doktoraturë | 27 | 40 | 67 | 40.3 | 59.7 |

Të dhënat mbi nivelin arsimor të popullatës në Bashkinë Pustec tregojnë një shpërndarje gjinore që pasqyron dinamika të rëndësishme sociale dhe sfida që lidhen me barazinë në aksesin dhe vazhdimësinë e arsimit. Kjo analizë është e rëndësishme për të kuptuar se si gjinia ndikon në mundësitë arsimore dhe cilat ndërhyrje janë të nevojshme për të nxitur pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në edukim.

**Asnjë nivel arsimor i përfunduar** – Në këtë kategori përfshihen gjithsej **18 persona,** nga të cilët **72.2% janë gra** dhe vetëm **27.8% burra.** Pabarazia e theksuar tregon se gratë kanë qenë më të ekspozuara ndaj mungesës së arsimit, veçanërisht në brezat më të vjetër dhe në zonat më të izoluara.

**Arsimi fillor** – Nga **171 persona** me arsim fillor, **62% janë gra dhe 38% burra**. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e grave nuk kanë pasur mundësi të vazhdojnë më tej arsimin, duke ndalur shkollimin në ciklin fillestar, çka mund të lidhet me faktorë si përgjegjësi të hershme familjare apo mungesë mbështetjeje sociale dhe ekonomike.

**Arsimi 7/8/9-vjeçar** – Me gjithsej **701 persona,** ky është niveli arsimor më i përhapur në popullatë. **53.6% janë gra dhe 46.4% burra**, duke treguar një përmirësim të qasjes në arsimin e detyrueshëm për të dyja gjinitë dhe një shpërndarje relativisht të balancuar.

**Arsimi i mesëm** – Në këtë kategori janë përfshirë **554 persona, ku 59.2% janë burra dhe 40.8% gra**. Kjo tregon një rënie të përfaqësimit të femrave në vazhdimin e arsimit pas ciklit 9-vjeçar, duke nënvizuar sfidat që vajzat përballen për të ndjekur shkollimin e mesëm, përfshirë faktorë kulturorë dhe ekonomikë.

[4] https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

**Bachelor** – Nga **85 persona** me diplomë bachelor, **51.8% janë burra dhe 48.2% gra,** çka përfaqëson një shpërndarje pothuajse të barabartë. Kjo tregon se ato gra që arrijnë të përfundojnë arsimin e mesëm kanë mundësi të krahasueshme me burrat për të vazhduar arsimin e lartë.

**Master ose Doktoraturë** – Në këtë kategori përfshihen **67 persona**, **ku gratë përbëjnë shumicën me 59.7%, kundrejt 40.3% të burrave**. Kjo tregon një rritje të angazhimit të grave në arsimin e avancuar dhe një përparim të ndjeshëm në pjesëmarrjen e tyre akademike në nivelet më të larta.

**Përmbledhje -** Të dhënat tregojnë një tendencë të dyfishtë: në nivelet më të ulëta të arsimimit, gratë përballen me pabarazi më të madhe, ndërsa në nivelet e larta arsimore, përfaqësimi i tyre përmirësohet dhe tejkalon atë të burrave. Kjo sugjeron se ndërhyrjet për promovimin e barazisë gjinore duhet të fokusohen veçanërisht në mbështetjen e vajzave për të mos braktisur shkollën pas ciklit të detyrueshëm dhe për të vazhduar arsimin e mesëm dhe të lartë. Edukimi si mjet për fuqizimin e grave duhet të mbështetet me politika të synuara, qasje të ndjeshme gjinore dhe përfshirje të komunitetit në nxitjen e rolit të barabartë të vajzave dhe grave në procesin arsimor.

Grafiku nr 2: Shpërndarja gjinore e popullsisë në Bashkinë Pustec sipas nivelit të arsimit të përfunduar.



## Statusi martesor

**Tabela nr. 6 – Popullsia mbi 10 vjeç sipas statusit martesor dhe gjinisë në Bashkinë Pustec**

| # | Emërtimi | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Beqar(e) | 243 | 146 | 389 | 62.5 | 37.5 |
| 2 | I/e martuar | 633 | 634 | 1267 | 50.0 | 50.0 |
| 3 | I/e divorcuar ose i/e ndarë | 7 | 1 | 8 | 87.5 | 12.5 |
| 4 | I/e ve | 48 | 131 | 179 | 26.8 | 73.2 |

Tabela nr. 6[5] paraqet shpërndarjen e popullsisë mbi 10 vjeç në Bashkinë Pustec sipas statusit martesor dhe gjinisë. Numri më i madh i individëve është i martuar, me përfaqësim të barabartë gjinor (50% meshkuj dhe 50% femra). Ndërkohë, në grupin e beqarëve dominojnë meshkujt (62.5%), ndërsa statusi i vejërisë është shumë më i përhapur tek femrat (73.2%), duke reflektuar jetëgjatësinë më të lartë të tyre dhe ndoshta norma më të ulëta rimartese.

**Grafiku nr. 3 – Shpërndarja e popullsisë sipas statusit martesor dhe gjinisë në Bashkinë Pustec**




[5]https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

Shpërndarja sipas statusit martesor në Bashkinë Pustec tregon dallime të dukshme gjinore që reflektojnë norma sociale, jetëgjatësinë dhe përjetimet e ndryshme të burrave dhe grave në lidhje me martesën, ndarjen dhe humbjen e partnerit.

**Në kategorinë "beqar(e)",** ka gjithsej **389 persona,** nga të cilët **62.5% janë burra dhe 37.5% gra**. Burrat përfaqësojnë shumicën e beqarëve, gjë që mund të lidhet me prirjen e tyre për t'u martuar më vonë ose për të qëndruar më gjatë beqarë krahasuar me gratë, por gjithashtu mund të tregojë edhe faktorë migrimi, përjashtim social apo mungesë partnerësh potencialë në komunitet.

**Në kategorinë "i/e martuar",** përfshihen **1,267 persona**, me një ndarje të barabartë gjinore – **50% burra dhe 50% gra** – duke treguar një përfshirje të qëndrueshme të të dy gjinive në institucionin e martesës dhe një strukturë familjare relativisht tradicionale dhe e balancuar.

**Në kategorinë "i/e divorcuar ose i/e ndarë"**, numri total është shumë i vogël (vetëm 8 persona), nga të cilët **87.5% janë burra dhe vetëm 12.5% gra**. Ky dallim i madh sugjeron se numri i grave të divorcuara që regjistrojnë këtë status është shumë i ulët, ndoshta për shkak të faktorëve kulturorë, stigmatizimit social, mungesës së aksesit në drejtësi ose varësisë ekonomike që pengon formalizimin e ndarjes.

**Në kategorinë "i/e ve"**, ka **179 persona, ku 73.2% janë gra dhe 26.8% burra**. Ky dallim është i pritshëm dhe pasqyron jetëgjatësinë më të lartë të grave, si dhe faktin që gratë kanë më pak gjasa të rimartohen pas humbjes së bashkëshortit. Kjo situatë mund të përkthehet në rritje të rrezikut për izolim social dhe vështirësi ekonomike për gratë e veja, veçanërisht në moshë të madhe.

Këto të dhëna tregojnë se gratë, në veçanti ato të moshuara ose të ndara, janë më të ekspozuara ndaj sfidave sociale dhe ekonomike. Kjo kërkon politika të ndjeshme ndaj gjinisë që adresojnë nevojat specifike të këtyre kategorive, përmes mbështetjes sociale, shërbimeve të përshtatura dhe përfshirjes së tyre aktive në jetën komunitare. Identifikimi i këtyre grupeve ndihmon në hartimin e masave efektive për barazi gjinore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët, pavarësisht statusit martesor.

## Statusi i nënës

**Tabela nr. 7 – Statusi i nënës sipas grupmoshës në Bashkinë Pustec[6]**

| Grupmosha | Kanë lindur | Nuk kanë lindur | Gjithsej | % kanë lindur | % NUK kanë lindur |
|---|---|---|---|---|---|
| 15-24 vjeç | 91 | 689 | 780 | 11.7 | 88.3 |
| 25-34 vjeç | 501 | 226 | 727 | 68.9 | 31.1 |
| 35-44 vjeç | 700 | 128 | 828 | 84.5 | 15.5 |
| 45-54 vjeç | 1064 | 164 | 1228 | 86.6 | 13.4 |
| 55-64 vjeç | 1412 | 196 | 1608 | 87.8 | 12.2 |
| 65-74 vjeç | 970 | 101 | 1071 | 90.6 | 9.4 |
| mbi 75 vjeç | 573 | 38 | 611 | 93.8 | 6.2 |

Tabela nr. 7 paraqet numrin e femrave që kanë lindur fëmijë sipas grupmoshave. Të dhënat tregojnë një rritje të përqindjes së grave që kanë lindur me shtimin e moshës, duke filluar nga vetëm 11.7% në grupmoshën 15–24 vjeç, deri në 93.8% për gratë mbi 75 vjeç. Kjo tendencë pasqyron ciklin natyror të lindshmërisë dhe normat e prindërisë nëpër breza.

**Grafiku nr. 4 – Përqindja e grave që kanë lindur sipas grupmoshës në Bashkinë Pustec**




[6]https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

Të dhënat mbi statusin e të qenit nënë në Bashkinë Pustec tregojnë se pjesa më e madhe e grave mbi 25 vjeç kanë lindur fëmijë, ndërsa përqindja e grave pa fëmijë është dukshëm më e lartë te grupmoshat më të reja. Kjo shpërndarje pasqyron ndryshime brezash dhe tendenca të reja në sjelljen riprodhuese.

**Në grupmoshën 15–24 vjeç**, vetëm **1.6% e vajzave dhe grave kanë lindur, ndërsa 98.4% nuk kanë lindur ende**. Kjo shifër është tregues pozitiv i faktit që lindja në moshë të re po bëhet gjithnjë e më pak e zakonshme, ndoshta për shkak të rritjes së përfshirjes në arsim, mungesës së stabilitetit ekonomik ose ndryshimeve në qëllimet personale dhe stilin e jetesës.

**Në grupmoshën 25–34 vjeç, 64% e grave kanë lindur, ndërsa 36% ende jo.** Kjo është një periudhë aktive për lindshmërinë dhe tregon se pjesa më e madhe e grave në këtë grup tashmë kanë hyrë në fazën prindërore. Megjithatë, përqindja e atyre që nuk kanë lindur është relativisht e lartë, duke sinjalizuar një tendencë për vonesë të mëtejshme të lindjes së parë.

**Në grupmoshën 35–44 vjeç, 95.5% e grave kanë lindur**, duke treguar se funksioni riprodhues në kuptimin tradicional është përmbushur në pothuajse të gjitha rastet. Kjo konfirmon se pas moshës 35 vjeç, shumica e grave tashmë janë bërë nëna.

**Në grupmoshat 45–54, 55–64, 65–74 dhe mbi 75 vjeç, përqindja e grave që kanë lindur varion nga 95.5% në 99.1%**. Këto shifra janë shumë të larta dhe reflektojnë normat e brezave të mëparshëm, kur lindshmëria e lartë dhe të pasurit fëmijë konsideroheshin pjesë e pandashme e rolit të gruas.

Kjo shpërndarje vërteton se po ndodh një tranzicion i qartë në sjelljen riprodhuese të grave, me brezat më të rinj që po zgjedhin të vonojnë ose rishikojnë rolin e mëmësisë në jetën e tyre. Faktorë si arsimimi, pavarësia ekonomike, ndryshimi i pritshmërive sociale dhe rritja e vetëdijes për planifikimin familjar luajnë një rol të rëndësishëm në këtë ndryshim.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për hartimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe shërbimeve të përshtatura për gratë në faza të ndryshme të jetës së tyre. Gratë më të reja mund të përfitojnë nga akses më i mirë në informacion mbi shëndetin riprodhues dhe mbështetje për pajtimin e jetës familjare me karrierën, ndërsa gratë që janë tashmë nëna mund të kenë nevojë për mbështetje përkujdesjeje, përfitime sociale apo shërbime të orientuara drejt mirëqenies së familjes.

## Frekuentimi i Çerdhes

**Tabela nr. 8 – Frekuentimi i çerdhes sipas gjinisë[7]**

| # | Emërtimi | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndjek Çerdhen | 5 | 8 | 13 | 38.5 | 61.5 |
| 2 | NUK ndjek çerdhen | 12 | 7 | 19 | 63.2 | 36.8 |

**Grafiku nr. 5 Përqindja e fëmijëve meshkuj dhe femra që ndjekin ose nuk ndjekin çerdhen.**




Nga gjithsej **32 fëmijë të moshës 0–3 vjeç** të raportuar në këtë përmbledhje, **13 fëmijë (rreth 40.6%) ndjekin çerdhen, ndërsa 19 fëmijë (rreth 59.4%) nuk ndjekin**.

Ndër fëmijët që ndjekin çerdhen, 38.5% janë djem dhe 61.5% vajza. Kjo shpërndarje tregon një përfaqësim më të lartë të vajzave në përfshirjen në çerdhe, ndonëse për shkak të numrit të vogël absolut, ky dallim duhet interpretuar me kujdes.

Nga ana tjetër, ndër fëmijët që **nuk ndjekin** çerdhen, 63.2% janë djem dhe 36.8% vajza. Kjo sugjeron se në këtë grup, djemtë janë më të përfaqësuar, duke sinjalizuar një mundësi që ata të përjashtohen më shpesh nga ky shërbim në këtë kontekst të veçantë.

[7] https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

Ajo që vihet re më qartë është se **vetëm 4 në 10 fëmijë** ndjekin çerdhen, ndërsa **shumica (6 në 10)** nuk përfitojnë nga ky shërbim në vitet e para të jetës. Kjo përqindje relativisht e ulët e përfshirjes mund të reflektojë kufizime të kapaciteteve infrastrukturore, mungesë çerdhesh në territor, kosto për familjet apo norma sociale që nxisin përkujdesjen në familje – zakonisht nga nëna.

Kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë gjinore: **kur shërbimet e kujdesit për fëmijët janë të kufizuara ose të paarritshme**, janë zakonisht **gratë** që marrin përsipër rolin kryesor të kujdesit, duke kufizuar mundësitë e tyre për punësim, arsimim apo pjesëmarrje në jetën publike.

Për këtë arsye, të dhënat theksojnë nevojën për **zgjerim të shërbimeve të çerdheve** dhe për politika që e bëjnë atë më të aksesueshëm për të gjitha familjet – si një hap kyç për të mbështetur **barazinë gjinore** dhe fuqizimin e grave në jetën sociale dhe ekonomike.

## Frekuentimi i Kopshtit

**Tabela nr. 9 – Frekuentimi i kopshtit sipas gjinisë (mosha 3-6 vjeç)[8]**

| # | Frekuentimi | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndjek kopshtin | 9 | 7 | 16 | 56.2 | 43.8 |
| 2 | NUK ndjek kopshtin | 5 | 5 | 10 | 50 | 50 |

Tabela nr. 9 tregon numrin dhe përqindjen e fëmijëve meshkuj dhe femra të moshës 3-6 vjeç që ndjekin ose nuk ndjekin kopshtin. Në grupin që ndjek kopshtin, meshkujt përbëjnë 56.2%, ndërsa femrat 43.8%. Ndërsa në grupin që nuk ndjek kopshtin, përqindjet janë të barabarta midis meshkujve dhe femrave. Në të dhënat e Bashkisë Pustec vihet re se janë gjithsej **26 fëmijë** të moshës 3–6 vjeç, **10 prej tyre (38.5%) nuk ndjekin kopshtin**, ndërsa **16 fëmijë (61.5%) janë të përfshirë** në këtë shërbim parashkollor. Kjo përqindje përfaqëson një përfshirje relativisht pozitive, por ende jo të plotë për këtë grupmoshë.

Në mesin e fëmijëve që **nuk ndjekin kopshtin**, djemtë dhe vajzat janë në numër të barabartë (nga 5 secili). Megjithatë, vlen të theksohet se **vajzat përfaqësojnë vetëm 43.8% të fëmijëve që ndjekin kopshtin**, ndërkohë që janë **50% e atyre që nuk e ndjekin**. Kjo sugjeron një prirje të lehtë që **vajzat të mbeten më shpesh jashtë kopshtit** krahasuar me djemtë, edhe pse numrat absolutë janë të vegjël.

Ky dallim, edhe pse i vogël, ka domethënie kur analizohet në një kontekst më të gjerë gjinor dhe kulturor. Në shoqërinë shqiptare, **kujdesi për fëmijët parashkollorë bie pothuajse ekskluzivisht mbi nënat**. Kur një vajzë mbetet jashtë institucioneve të

[8]https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

edukimit të hershëm, ka më shumë gjasa që nëna e saj të qëndrojë në shtëpi për t'u kujdesur për të, duke reduktuar kështu mundësitë për të punuar me kohë të plotë ose për të ndjekur zhvillimin personal dhe profesional.

Prandaj, edhe një përqindje e vogël më e lartë e vajzave jashtë kopshtit kontribuon në **ciklin e pabarazisë gjinore**:

- Vajzat kanë më pak akses në edukimin e hershëm;
- Nënat mbajnë barrën kryesore të kujdesit;
- Mundësitë për punësim dhe pavarësi ekonomike për gratë reduktohen;
- Pabarazitë gjinore në familje dhe në shoqëri thellohen.

Kjo tendencë, edhe në një bashki të vogël si Pusteci, duhet të konsiderohet me serioz në hartimin e **planit vendor për barazinë gjinore**, me masa si:

- Rritja e përfshirjes së vajzave në kopsht përmes fushatave ndërgjegjësuese;
- Zgjerimi i kapaciteteve të institucioneve parashkollore;
- Ofrimi i lehtësirave për prindërit që punojnë (p.sh., orare të zgjeruara, transport);
- Nxitja e ndarjes së barabartë të përgjegjësive të kujdesit brenda familjes, duke përfshirë më shumë edhe baballarët në kujdesin ndaj fëmijëve.

Në këtë mënyrë, të dhënat shërbejnë jo vetëm për të analizuar situatën aktuale, por edhe si **bazë për ndërhyrje të qëndrueshme në promovimin e barazisë gjinore** që nis që në fëmijëri.

## Të Dhëna mbi Personat me Aftësi të Kufizuar në Bashki

**Tabela nr. 10 – Numri i personave me aftësi të kufizuar sipas grupmoshave dhe gjinisë në Bashkinë Pustec[9]**

| Grupmosha | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|
| 5-14 vjeç | 1 | 0 | 1 | 100 | 0 |
| 15-64 vjeç | 10 | 17 | 27 | 37.0 | 63.0 |
| mbi 65 vjeç | 33 | 45 | 78 | 42.3 | 57.7 |

Tabela nr. 10 tregon shpërndarjen gjinore dhe sipas grupmoshave të personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Pustec. Numri më i madh i tyre është në grupmoshën mbi 65 vjeç, ku femrat përbëjnë 57.7%. Në grupmoshën 15-64 vjeç, femrat gjithashtu janë në shumicë (63%), ndërsa te grupmosha 5-14 vjeç ka vetëm një rast të regjistruar, i cili është mashkull.

[9] https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/

**Grafiku nr. 6 – Personat me aftësi të kufizuar sipas grupmoshave dhe gjinisë në Bashkinë Pustec**




Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Pustec tregojnë një prirje të qartë gjinore që ka ndikim në barazinë dhe përfshirjen sociale të grave.

**Në grupmoshën 5–14 vjeç**, numri i personave me aftësi të kufizuara është shumë i ulët dhe përbëhet vetëm nga një djalë, ndërsa nuk ka të dhëna për vajza në këtë grupmoshë.

**Në grupmoshën 15–64 vjeç**, gratë përbëjnë 63% të personave me aftësi të kufizuara, ndërsa meshkujt 37%, duke reflektuar një përqindje dukshëm më të lartë të grave.

**Në grupmoshën mbi 65 vjeç,** gratë janë 57.7% e këtij grupi, edhe pse diferenca me meshkujt është më e vogël, ajo mbetet në favor të grave.

Analiza sipas llojit të vështirësisë tregon se **në të gjitha kategoritë gratë dominojnë**. **Më e lartë** është përqindja e tyre në **vështirësitë në kujtesë**, ku përbëjnë **66.7%**, dhe në **kujdesin e përditshëm ndaj vetes, me 65.7%**. Gjithashtu, gratë përbëjnë mbi **60% në vështirësitë për ecje (63.9%), shikim (65.1%), dëgjim (61.4%) dhe komunikim (65.6%)**.

Kjo tregon se gratë me aftësi të kufizuara në Pustec përballen me vështirësi të shumta në fusha të ndryshme funksionale, duke reflektuar pengesa të natyrës fizike, sociale dhe ekonomike. Përqindjet e larta të grave në këto kategori nënvizojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të specializuara për mbrojtjen, përkrahjen dhe përfshirjen e tyre të plotë në shoqëri.

Këto të dhëna evidentojnë nevojën për politika sociale dhe plane konkrete nga Bashkia Pustec për të siguruar infrastrukturë të aksesueshme, shërbime të specializuara shëndetësore dhe sociale, si dhe mbështetje në përfshirjen në tregun e punës. Përfshirja aktive e grave me aftësi të kufizuara në proceset e planifikimit gjinor është thelbësore për të ndërtuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

**Tabela nr. 11 – Personat me aftësi të kufizuar sipas llojit të vështirësisë dhe gjinisë në Bashkinë Pustec[10]**

| # | Lloji i vështirësisë | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % Meshkuj | % Femra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Në shikim | 15 | 28 | 43 | 34.9 | 65.1 |
| 2 | Në dëgjim | 17 | 27 | 44 | 38.6 | 61.4 |
| 3 | Në ecje | 22 | 39 | 61 | 36.1 | 63.9 |
| 4 | Kujtesë | 11 | 22 | 33 | 33.3 | 66.7 |
| 5 | Kujdesin e përditshëm ndaj vetes | 12 | 23 | 35 | 34.3 | 65.7 |
| 6 | Në komunikim | 11 | 21 | 32 | 34.4 | 65.6 |

Tabela nr. 11 paraqet shpërndarjen gjinore të personave me aftësi të kufizuar, të ndarë sipas llojeve të ndryshme të vështirësive (shikimi, dëgjimi, ecja, kujtesa, kujdesi personal dhe komunikimi). Femrat dominojnë në të gjitha kategoritë, duke përbërë mbi 60% të rasteve në secilën kategori, çka nënvizon rëndësinë e përfshirjes së tyre në politika sociale dhe programe mbështetëse në Bashkinë Pustec.

**Grafiku nr. 7 – Personat me aftësi të kufizuar sipas llojit të vështirësisë dhe gjinisë në Bashkinë Pustec**

[10] https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__Census2023__Census_Bashki/CENS_34/table/tableViewLayout1/




## Punëkërkuesit e papunë sipas njësive administrative

Në Bashkinë Pustec janë **vetëm 10 individë të regjistruar si punëkërkues të papunë** në zyrën përkatëse të punësimit. Kjo shifër përfaqëson një përqindje të ulët në raport me popullsinë në moshë pune (rreth 2,620 meshkuj + 2,438 femra = 5,058 banorë gjithsej), dhe me **55 përfitues të ndihmës ekonomike në grupmoshën 19–64 vjeç**, që konsiderohen ekonomikisht aktivë.

Shifra **nuk reflekton domosdoshmërisht nivelin real të papunësisë**, por më shumë nivelin e **regjistrimit formal në zyrën e punës**. Shkaqet kryesore për këtë nënregjistrim mund të jenë:

- mungesa e informacionit mbi përfitimet e regjistrimit,
- mosfunksionimi i rregullt i zyrës së punës në territorin e bashkisë,
- mungesa e besimit nga qytetarët për mundësi reale punësimi nëpërmjet zyrës së punës,
- emigracioni informal ose vetëpunësimi në bujqësi (i paregjistruar)

**Punëkërkuesit e papunë sipas Gjinisë**

Ndër 10 punëkërkuesit e regjistruar në zyrën e punës në Pustec:

• Gratë përfaqësojnë vetëm 40% të totalit, gjë që mund të interpretohet në disa mënyra:

- barrierat që gratë përballen për të hyrë në tregun e punës (kujdesi për fëmijët, stereotipe gjinore, mungesë transporti);
- mungesë informacioni ose përjashtim social i grave, veçanërisht në komunitetet rurale;
- ose përfshirje e grave në punë informale të paregjistruara (bujqësi, ekonomi shtëpiake, ndihmë familjare).

• Burrat janë më të përfaqësuar në regjistrim (60%), por kjo nuk do të thotë që janë më të papunë – thjesht mund të jenë më të prirur të regjistrohen.

**Grupet Vulnerabël të Punëkërkuesve të Papunë**

Vetëm 1 punëkërkuese është kryefamiljare grua.

Nuk ka punëkërkues të regjistruar nga kategoritë Rome/Egjiptiane, Emigrantë, apo PAK (Persona me Aftësi të Kufizuara).

**Trajnimet Profesionale**

Të dhënat tregojnë një mungesë totale të shërbimeve aktive të tregut të punës në Bashkinë Pustec. Ndërkohë që janë të regjistruar 10 persona të papunë në moshë pune (të gjithë përfitues të ndihmës ekonomike), nuk rezulton të jenë ofruar:

- asnjë trajnim profesional,
- asnjë përfitim nga trajnime,
- dhe asnjë ndërmjetësim për punësim.

Kjo situatë reflekton një mospërputhje të theksuar midis nevojave të të papunëve dhe ndërhyrjeve aktive të tregut të punës, duke rritur rrezikun e mbetjes afatgjatë në skemën e ndihmës ekonomike.

**Bizneset në territorin e Bashkisë Pustec**

Sipas të dhënave të raportuara nga sektori i tatim-taksave, **në Bashkinë Pustec janë të regjistruara gjithsej 17 biznese[11].**

- Ky numër është jashtëzakonisht i ulët, duke marrë parasysh sipërfaqen dhe nevojat socio-ekonomike të zonës.
- Një treg me kaq pak biznese nuk mund të mbështesë punësim të qëndrueshëm apo zhvillim lokal, sidomos në një situatë kur papunësia dhe varësia nga ndihma ekonomike janë të larta.
- Për më tepër, mungesa e një sektori aktiv privat i ul ndjeshëm edhe mundësinë për të ofruar praktika profesionale për të rinjtë dhe gratë, duke ndikuar negativisht në integrimin e grupeve vulnerabël në tregun e punës.

[11]https://www.bashkiapustec.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/PUBLIKIM-TAKSAT-DHE-TARIFAT-VENDORE-NE-BASHKINE-PUSTEC-PER-VITIN-2025.pdf

- Numri total i bizneseve të vogla të regjistruara: **17**
- Numri i bizneseve të regjistruara deri më 31.12.2024: **18**
- Numri i bizneseve të mbyllura gjatë vitit 2024: **1**
- Numri i bizneseve informale: **0**
- Fusha kryesore e aktivitetit ekonomik: **Peshkimi**

# Metodologjia

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e bashkisë, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmoshave, niveli arsimor, normat e analfabetizmit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuar, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit.

Analiza mori gjithashtu në konsideratë diferencat midis zonave urbane dhe rurale të territorit të bashkisë, për të kuptuar nëse sfidat gjinore janë homogjene apo të ndikuara nga konteksti gjeografik dhe social. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e nevojave të ndryshme në nivel njësie administrative dhe krijoi bazën për përshtatjen e ndërhyrjeve në planin e veprimit.

Në aspektin institucional, u analizua struktura ekzistuese dhe funksionaliteti i mekanizmave për barazinë gjinore brenda bashkisë. Konkretisht, u shqyrtua nëse bashkia kishte miratuar Kartën për Barazinë Gjinore, nëse Komisioni për Barazi Gjinore pranë Këshillit Bashkiak ishte funksional, dhe nëse Aleanca e Grave Këshilltare ishte aktive dhe me mbështetje buxhetore. Po ashtu, u vlerësua ekzistenca dhe roli i punonjësit të barazisë gjinore brenda administratës, pozicionimi i tij në

strukturë (veçmas apo i lidhur me dhunën në familje), dhe çfarë roli dhe detyrash janë përcaktuar në përshkrimet e punës apo në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë ka qenë edhe vlerësimi i kapacitetit për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet publike, përmes ngritjes së një Komisioni të Administratës për Barazi Gjinore. U vlerësua nëse komisioni ekziston, është ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologj ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.

## Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, Bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

## Qëllimet dhe objektivat strategjike

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë Pustec 2026–2028 ndërtohet mbi **dy qëllime strategjike**, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Këto qëllime janë të përkthyera në objektiva specifikë dhe aktivitete konkrete, që mund të zbatohen, monitorohen dhe matën përgjatë një periudhe trevjeçare.

**Qëllimi Strategjik 1 (Q1):**

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky synim ka për qëllim konsolidimin e qeverisjes vendore, duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një pjesë thelbësore dhe funksionale të mënyrës se si organizohet, menaxhohet dhe zhvillohet Bashkia. Në këtë kuadër, barazia gjinore nuk shihet si një objektiv i izoluar, por si një qasje ndërsektoriale që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse, planifikuese, menaxheriale dhe raportuese të qeverisjes vendore.

Vëmendja përqendrohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke siguruar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të barabartë në shërbimet publike.

Për të realizuar këtë vizion, është e domosdoshme që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet institucionale, si dhe në mënyrën e komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e mekanizmave të brendshëm për monitorim dhe llogaridhënie, si dhe fuqizimin e rolit të aktorëve vendorë — përfshirë këshillat bashkiakë, administratën vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin — në promovimin e barazisë gjinore si një element të pandashëm të qeverisjes së mirë.

Qëllimi Strategjik 1 përfshin tre objektiva specifikë:

- **1.1.** Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të raportimit publik mbi progresin për barazinë gjinore, duke përdorur të dhëna gjinore dhe platforma digjitale.
- **1.2.** Fuqizimi i mekanizmave institucionalë lokalë që merren me çështjet gjinore, përmes ngritjes së strukturave përfaqësuese, trajnimeve dhe rregulloreve funksionale.
- **1.3.** Nxitja dhe zgjerimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet me komunitetin.

**Qëllimi Strategjik 2 (Q2):**

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cenueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Ky qëllim kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

Qëllimi Strategjik 2 konkretizohet në katër objektiva specifikë:

- **2.1.** Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike.
- **2.2.** Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
- **2.3.** Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm.
- **2.4.** Promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbajtjes dhe pjesëmarrjes së barabartë.

## 5. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi strategjik 1:

**Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.**

| **Objektivi Specifik (O1.1)** Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare. | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Aktivitete** | **Periudha e zbatimit** | **Përgjegjës** | **Partnerë** | **Burimet financiare** | **Tregues** |
| 1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë dhe të KBRE-së. | 2026 | Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare web të bashkisë; IT I/e bashkisë | Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare | 5,000 lekë<br>(faqe web, staf teknik) | Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare |
| 1.1.2 Hartimi i udhëzimeve dhe tabelave të treguesve për monitorim. | 2026 | Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e performancës | Njësia përgjegjëse për hartimin e statistikave/performancës | 90,000 lekë(dizajnim + printim udhëzues) | Dokument i përfunduar dhe shpërndarë në drejtoritë përkatëse |
| 1.1.3. Njohja me intrumentet matëse për mbledhjen e të dhënave. | 2026 | Njësia e Burimeve Njerëzore | INSTAT, donatorë | | Numri i punonjësve të njohur me instrumentat matëse për mbledhje e të dhënave. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.14. Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të dhënave me tregues gjinorë. | 2026 - 2028 | Njësia e Burimeve Njerëzore | INSTAT, donatorë | 180,000 lekë (trajnerë + logjistikë) | Numri i punonjësve të trajnuar dhe vlerësimi pas-trajnimit |
| 1.1.5 Krijimi i një platforme online të hapur për publikimin e statistikave dhe konsultime publike për masat për barazinë gjinore në Bashki | 2026 - 2027 | IT I/e bashkisë | AKSHI, Shoqëria Civile | 450,000 lekë (zhvillim platforme, miëmbajtje 1 vit) | Platforma funksionale dhe numri i përdoruesve aktivë |
